



Formulari / Dokumenti / Formular / Document / Formular / Document	22. 10. 2020	0	viti / god / year
Organ / Njesia / Organ / Unit / Organ / Unit	Nr Prot / Br Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPMSHACK	2220/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.245/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri - Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.245/2020 të datës 25/08/2020 të parashtruar nga ankuesit [redacted], dhe [redacted], të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat Sheremet Ademi dhe Avokat Leutrim Ademi me adresë rruga "Afrim Zhitia" pa numër në Mitrovicë, kundër organit të punësimit-Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, në çështjen juridike "kompensim i pagave jubilarë dhe shujtës ushqimore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 22.10.2020, mori këtë

V E N D I M

I. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.245/2020 e datës 25/08/2020 të parashtruar nga ankuesit [redacted], Xhemajl Uksmajli, Lavdim Bajrami, Pajtim Rrustemi, Azem Jashari, Ibrahim Qunaku, dhe Ramadan Topuzi.

II. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me datë 28/02/2020, Sindikata e Pavarur e Universiteti të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, përmes shkresës me numër protokolli 745/20 ka kërkuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit, kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtës ushqimore për punonjësit e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Këshilli Drejtues i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, më datë 02/03/2020 ka nxjerr Vendimin me Nr. prot:766/20 me të cilin ka refuzuar kërkesën e datës 28/02/2020 të parashtruar nga Sindikata e Pavarur, me arsyetimin së Universiteti nuk ka mjete financiare të destinuar në buxhet për kompensimin e këtyre kategorive.

Të pakënaqur me vendimin Nr.prot:766/20 të Këshillit Drejtues të Universiteti të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, të punësuarit e këtij Universiteti: [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], dhe [redacted] përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim Avokatit Sheremet Ademi, me datë 21/08/2020 nëpërmjet postës kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ankesa në Këshill është pranuar më datë 25/08/2020 dhe është regjistruar me A.nr.245/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 02/09/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj. Më datë 22/09/2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1614/2020 të datës 25/08/2020 e regjistruar me numër A.nr.245/2020 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën me numër protokollit 745/20 të datës 28.02.2020 për kompensim të pagave jubilarë dhe shujtës ditore drejtuar Këshillit Drejtues të UShAF-së; Vendimin me Nr. prot:766/20 të datës 02/03/2020 të Këshillit Drejtues të UShAF-së; Autorizimet e datës 05/03/2020 dhe 11/03/2020; Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 18/04/2017; Akt Emërimin e datës 05/10/2016 të Njazi Ramadani; Vendimin e datës 11/08/2016 për Azem Jashari; Akt Emërimin e datës 11/01/2018 për Blerina Bytyçi; Akt Emërimin e datës 05/10/2016 për Besa Rexhepi; Akt Emetimin e datës 05/10/2016 për Hanumshahe Zuka; Akt Emërimin e datës 05/10/2016 për Armend Hysa; Akt Emërimin e datës 02/03/2020 për Lavdim Bajrami; Akt Emërimin e datës 02/03/2020 për Lendita Rreba-Selimi; Akt Emërimin e datës 30/03/2020 për Leonora Sylejmani; Akt Emërimin e datës 30/03/2020 për Pajtim Rrustemi; Akt Emërimin e datës 30/03/2020 për Xhemajl Uksmajli; Akt Emërimin e datës 20/12/2019 për Vjollca Musolli; Akt Emërimin e datës 05/10/2016 për Ganimete Heta; Akt Emërimin e datës 08/11/2018 për Fatime Musliu; si dhe kërkesën për shtyrje të afatit për vendosje të ankesës e datës 14/10/2020 dhe Vendimi më Nr.1/2020 i datës 14/10/2020 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueseve: [redacted], dhe [redacted] është e palejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesit të përfaqësuar nga Sindikata e Pavarur e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj me datë 28/02/2020 përmes shkresës 745/20 kanë kërkuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtës ditore, bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Këshilli Drejtues i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj më datë 02/03/2020 ka nxjerr Vendimin me Nr. prot:766/20 përmes të cilin ka refuzuar kërkesën e datës 28/02/2020 të parashtruar nga ankuesit. Kundër këtij vendimi, ankuesit nëpërmjet përfaqësuesit të tyre me autorizim Avokatit Sheremet Ademi dhe Avokatit Leotrim Ademi nga Mitrovica, me datë 21/08/2020, nëpërmjet postës kanë parashtruar ankesën me Nr. prot:1614 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, veprim ky në kundërshtim me dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë afatin kohor për parashtrimin e ankesës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankesa e ankuesve për kompensimin e shujtës ditore është parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh të përcaktuar me dispozitat e nenit 127, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.** Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se ankesa e ankuesve është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka vlerësuar së nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesve por ka vendosur njëzëri që ankesën me numër A.nr.245/2020 të datës 25/08/2020 ta hedh poshtë si të palejuar në përputhje me nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.245/2020

Ilire Mehmeti - Shaqiri

Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve Avokatit Sheremet Ademi dhe Avokatit Leutrim Ademi;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;
- Arkivit të KPMSHCK-së.